



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 2 dhe 8, lidhur me nenin 21, të Ligjit për financat e pushtetit lokal, Nr. 03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008”, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-108 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2016”, e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), lidhur me nenin 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, te Statutit te Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, 31.05.2023, miraton këtë;

## V E N D I M

Për faljen e borxhit të pa paguar

### Neni 1

Me këtë vendim bëhet falja e borxhit të pa paguar **për shfrytëzimin e palestrës sportive “13 Qershori”**, për të gjithë Klubet sportive dhe shfrytëzuesit tjerë, të cilit aktivitetet e tyre i kanë zhvilluar nga data **01.01.2010 deri me 31.05.2023** në palestrën sportive “13 qershori”.

### Neni 2

Me miratimin e këtij vendimi, do të shlyhen nga evidenca e borxheve të pa paguara për shfrytëzimin e palestrës sportive “13 Qershori”, të gjitha borxhet e taksapaguesve, përfituesve nga periudha e cekur në nenin 1, të këtij vendimi nga zyrtaret përgjegjës të Drejtorisë për kulturë, rini, sport dhe mërgatë e Komunës së Suharekës.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për kulturë, rini, sport dhe mërgatë dhe Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet e Komunës së Suharekës.


### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-34863  
Më datë 31.05.2023



Kryesuesi i Kuvendit  
  
Mr.ec Bexhet KUÇI